



Periodiku AMF

I. Prezantimi i projektligjit “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”

Autoriteti i Mbiqëqyrjes Financiare, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, organizoi në ambientet e Hotel Tirana International një takim me industrinë e sigurimeve për të paraqitur projektligjin e ri “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.
Vijon në faqen 2

II. Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

II. 1 Vështrim mbi tregun e sigurimeve për periudhën janar-maj 2008

Në periudhën janar – maj 2008, primet e shkruara bruto kapën vlerën prej 2,627,041 mijë lekë, përkundrajt 2,276,639 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2007.
Vijon në faqen 3

III. Ngjarje dhe zhvillime të tjera

III. 1 Takimi i radhës i IOPS (24-25 qershor 2008) në Paris dhe grupi i punës i OECD për pensionet private (24 qershor 2008)

Organizata Ndërkombëtare e Mbiqëqyrësve të Pensioneve (IOPS), në bashkëpunim me Organizatën për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) zhvilluan në Paris, Francë gjatë periudhës 24-25 qershor 2008, takimet e mëposhtme:
a) Grupi i punës për pensionet private, OECD, 24 qershor 2008.
Vijon në faqen 4

III. 2 Vizitë pranë Autoritetit të Tregjeve Financiare Austriake, me qëllim studimin e sistemit të raportimit statistikor të shoqërive të sigurimit me aktivitet në Austri

Nga data 9-10 qershor 2008, pranë zyrave të FMA, u organizua në formën e një seminari dy ditor, vizita me qëllim studimin e sistemit të raportimit statistikor të shoqërive të sigurimit me aktivitet në Austri.
Vijon në faqen 6

III. 3 Pjesëmarrje në seminarin “Mbi disa aspekte të veçanta të politikave të tregut të brendshëm në Bashkimin Evropian”

Njëسيا e Ndërtimit të Institucioneve të Bashkimit Evropian (TAIEX) organizoi një seminar, më datë 30.06.2008, në ambientet e Hotel Tirana Internacional, “Mbi disa aspekte të veçanta të politikave të tregut të brendshëm në Bashkimin Evropian”.
Vijon në faqen 8

III. 4 Pjesëmarrje në seminarin e organizuar në Stamboll, mbi aspektet e rregullimit të paketës kontrolluese të aksioneve

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO), EMC Working Group, Bordi i Tregut të Kapitaleve të Turqisë dhe Autoriteti i Mbiqëqyrjes Financiare Polake, organizuan në Stamboll, Turqi, gjatë periudhës 11 – 14 qershor 2008 seminarin, mbi aspektet e rregullimit të paketës kontrolluese të aksioneve.
Vijon në faqen 8

III. 5 Takimi i shtatë në Lisbonë “Mbi sigurimet shoqërore dhe sistemet e fondeve të pensioneve suplementare, etika dhe qeverisja e tyre”

Qendra e kërkimit të ISEG (CIEF) së bashku me Institutin Qendror të Universitetit Teknik të Lisbonës, ISEG, zhvilluan në ambientet e Universitetit Teknik të Lisbonës, Portugali, në datën 6 qershor 2008, takimin e shtatë, mbi sigurimet shoqërore dhe sistemet e fondeve të pensioneve suplementare, etika dhe qeverisja e tyre.
Vijon në faqen 10

III. 6 Vizitë studimore, me qëllim studimin e sistemit të raportimit statistikor Vizor In-Reg të shoqërive të sigurimit me aktivitet në Slloveni

Nga data 19-20 qershor 2008, në Agjencinë e Mbiqëqyrjes së Sigurimeve në Slloveni (ISA), u zhvillua seminari, me qëllim studimin e sistemit të raportimit statistikor Vizor In-Reg të shoqërive të sigurimit me aktivitet në Slloveni.
Vijon në faqen 10

III. 7 Pjesëmarrje në seminarin rajonal të CEIOPS, Solvency II

CEIOPS (Komiteti Evropian i Mbiqëqyrjes për Sigurimet dhe Pensionet) dhe Komisioni i Mbiqëqyrjes së Sigurimeve të Rumanisë, zhvilluan në Bukuresht, gjatë periudhës 12-13 qershor 2008, seminarin rajonal me temë “Solvency II”.
Vijon në faqen 12

IV. Udhëzime të OECD-IOPS mbi licencimin e instituteve të pensionit

Këto udhëzime, të përgatitura nga Komiteti i Sigurimeve dhe Pensioneve Private të OECD, Grupi i Punës për Pensionet Private dhe IOPS, janë miratuar nga Këshilli i OECD, në Mars 2008.
Vijon në faqen 13

Në këtë numër:

Prezantimi i projektligjit “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” **2**

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura **3**

Ngjarje dhe zhvillime të tjera **4**

Udhëzime të OECD-IOPS mbi licencimin e instituteve të pensionit **13**

I. Prezantimi i projektligjit “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, organizoi në ambientet e Hotel Tirana International një takim me industrinë e sigurimeve për të paraqitur projekt ligjin e ri “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”. Në takim mori pjesë Ministri i Financave, Z. Ridvan Bode, Kryetarja e AMF-së Zj. Elisabeta Gjoni dhe drejtues të shoqërive të sigurimit në Shqipëri.

Projektligji është hartuar me bashkëpunim të Ministrisë së Financave dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Domosdoshmëria për hartimin e tij erdhi si rezultat i zhvillimeve në tregun e sigurimeve të detyrueshme në Shqipëri, krijimit të AMF-së si rregullator i pavarur dhe tendencave ndërkombëtare të rregullimit të sigurimeve të detyrueshme, përfshirë këtu direktivat Evropiane.

Ky projekt sjell për herë të parë detyrimin për sigurimin e pasagjerëve në transportin publik nga ana e pronarëve të mjeteve dhe sigurimin e



përgjegjësisë ligjore të pronarëve të anijeve dhe avionëve për dëmet që mund të shkaktohen nga përdorimi i këtyre mjeteve.

Projektligji parashikon funksionimin e Qendrës së Informacionit, që do të përmbajë të dhëna të plota mbi të gjitha mjetet e siguruar dhe dëmet e shkaktuara prej tyre. Qendra e informacionit mbështet përpjekjet e deritanishme për funksionimin e regjistrimit të të dhënave të sigurimit të detyrueshëm motorrik dhe pasurimin e tij me të dhënat e detajuara të dëmeve. Në projekt parashikohet shkëmbimi i informacionit me autoritetet publike të transportit dhe policisë rrugore.

Përmirësimi i infrastrukturës së dëmeve nëpërmjet përfshirjes së koncepteve të reja, si rimbursimi i drejtpërdrejtë dhe dëmi moral, shoqërohet edhe me procedura dhe afate të përcaktuara në trajtimin e dëmeve sipas direktivave Evropiane. Harmonizimi i arkitekturës institucionale dhe përmirësimi i zbatueshmërisë parashikohen në mënyrë të veçantë në projekt.

Projektligji i ri pritet të sjellë uljen e numrit të të pasiguarve në sigurimet e detyrueshme motorrike, sigurimin në masë të anijeve dhe avionëve dhe përmirësim në sjelljen e shoqërive në lidhje me pagesat e dëmeve. Të

gjitha këto janë në funksion të mbrojtjes së interesave të publikut, zhvillimit të tregut të sigurimeve dhe përjasjes më direktivat Evropiane, në kuadër të angazhimit të vendit me marrëveshjen e MSA-së.

Në takim u diskutua iniciativa e Bankës Botërore për hartimin e një skeme rajonale të sigurimit për mbrojtjen nga katastrofat natyrore. Kjo skemë që mendohet të përfshijë vendet e Evropës Jug Lindore do të garantojë financiarisht pronarët e shtëpive dhe bizneseve në rast të dëmtimit të pronave të tyre nga katastrofat natyrore. Shqipëria është vendi i parë që ka mbështetur këtë iniciativë që pritet të realizohet në harkun e dy viteve.

Në takim u diskutuan çështje të tjera të rëndësishme që lidhen me zhvillimin e sektorit të sigurimeve në Shqipëri.

II. Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

II.1 Vështrim mbi tregun e sigurimeve për periudhën janar-maj 2008

Në periudhën janar – maj 2008, primet e shkruara bruto kapën vlerën prej 2,627,041 mijë lekë, përkundrejt 2,276,639 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2007. Tregu i sigurimeve shënoi një rritje në masën 15.39% nga viti i kaluar, ku 80.56% e kësaj rritjeje i takon tregut të sigurimeve të Jo Jetës, ndërsa 19.44% tregut të sigurimeve të Jetës. Përsa i takon rritjes së tregjeve në veçanti, u

shënua një rritje në masën 44.81% të sigurimeve të Jetës dhe 13.29% të sigurimeve të Jo Jetës.

Në periudhën janar – maj 2008, volumi i primeve të sigurimit të detyrueshëm u rrit në masën 4.63%, ndërsa volumi i primeve të sigurimit vullnetar të Jo Jetës u rrit në masën 36.36%.

Në periudhën janar – maj 2008 u lidhën 228,061 kontrata sigurimi përkundrejt 198,388 kontrata të lidhura në të njëjtën periudhë të vitit 2007. Numri i kontratave të sigurimit të Jo Jetës kapi vlerën 207,534 nga 184,552 që i takojnë të njëjtës periudhë të një viti më parë. Portofoli MTPL ka shënuar rritjen më të madhe të numrit të kontratave me 8,457 kontrata ose në masën 9.55% më shumë se janar – maj 2007.


Vlen të përmendet rritja në masën 48.36% e numrit të kontratave të sigurimit të Jetës kundrejt të njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Numri i kontratave të sigurimit të Jetës kapi vlerën 20,527, nga të cilat sigurimi "Jeta dhe Shëndeti në udhëtim" pati një rritje prej 2,531 kontrata ose 58.85% duke shënuar dhe dinamikën më të lartë në rritjen e kontratave të sigurimit të Jetës.

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar - maj 2008 ishte rreth 518,168 mijë lekë, ose 20.59% më pak se në janar - maj të vitit 2007. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto u përket sigurimeve motorrike me 424,704 mijë lekë, apo 84.58% të totalit. Kjo ulje në dëmet e paguara bruto ndihet në potofolin "Kartoni Jeshil" ku kemi një ulje të dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimit me rreth 58.12% dhe ulje të numrit të dëmeve të paguara me rreth 37.19% krahasuar me 5 mujorin e parë të vitit 2007.


Tabelë: Volumi i primit të shkruar bruto në periudhën janar - maj (2007 – 2008)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë Lekë)	
	2007	2008
Periudha janar - maj		
A) Sigurim i Jetës	152,002	220,112
B) Sigurim i Jo Jetës	2,124,637	2,406,928
nga këto		
a) Sigurimi Detyrueshëm	1,545,112	1,616,692
b) Sigurimi Vullnetar	579,526	790,236
TOTAL	2,276,639	2,627,041

Grafik: Volumi i primit të shkruar bruto në periudhën janar – maj 2008 (Jeta dhe Jo Jeta)



Grafik: Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit për periudhën janar – maj 2008 (Jo Jeta)



III. Ngjarje dhe zhvillime të tjera

III.1 Takimi i radhës i IOPS (24-25 qershor 2008) në Paris dhe grupi i punës i OECD për pensionet private (24 qershor 2008)

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS)¹, në bashkëpunim me Organizatën për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD)² zhvilluan në Paris, Francë gjatë periudhës 24-25 qershor 2008, takimet e mëposhtme:

- a) Grupi i punës për pensionet private, OECD, 24 qershor 2008.
- b) Takimi i komiteteve teknike dhe ekzekutive të IOPS, në datat 24-25 qershor 2008.

Në ditën e parë u zhvillua mbledhja e grupit të punës për pensionet private, OECD. Anëtarët e IOPS ishin të ftuar si vëzhgues. Në këtë ditë u trajtuan çështje me mjaft interes si (i) Opsione politike për fazën e pagesës; (ii) Përfitimet pas punësimit, (iii) Zhvillime të reja në llogaritjen e pensioneve; (iv) Propozime për rishikimin në IAS 19 (v) Eksperienca e SHBA në regjistrimin automatik, (vi) Forma e përfitimeve në pension, (vii) Edukimi financiar dhe anuities, etj.

Me mjaft interes ishte materiali në lidhje me rishikimin e IAS në disa pika, nga të cilat disa kanë të bëjnë me ndryshime substanciale në lidhje me mënyrën se si shoqëritë bëjnë llogaritjet për premtimet e pensioneve. Ndryshimi kryesor i propozuar nga IASB³ ishte futja e një klasifikimi të ri për premtimet e pensioneve, të cilat nuk do të klasifikohen më si DB ose DC. Në dallim, këto premtime, të cilat përmbushin specifikimet (të cituara më poshtë) do të klasifikohen si premtime “me bazë kontributi” (contribution-based). Çdo premtim që nuk futet në këtë kategori do të klasifikohet si DB.

IASB propozon të përcaktojë planet me bazë kontributi si më poshtë:

Një premtim me bazë kontributi është një premtim përfitimi pas punësimit në të cilin, gjatë fazës së akumulimit, përfitimi mund të shprehet si:

- o Akumulim i kontributeve aktuale ose nocionale (virtuale) që, për çdo periudhë raportimi, do të njihen në fund të periudhës, përveç efektit të ndonjë risku të vesting (periudha e kualifikimit) ose demografik; dhe
- o Çdo kthim i premtuar në kontributet aktuale ose nocionale lidhet me kthimin prej një asemi, grup asetesh ose një indeksi. Një premtim me bazë kontributi nuk ka nevojë të

përfshijë një kthim të premtuar. Kjo temë ishte shumë e ndjeshme për të pranishmit dhe pati reagime në lidhje me vështirësitë që lidhen me adoptimin e këtyre standardeve.

Në ditën e dytë u zhvillua takimi i radhës së IOPS, i cili pasoi takimin e mbajtur në Washington DC në muajin Prill 2008. Shumë projekte dhe studime të nisura dhe në vazhdim u shqyrtuan për ecurinë dhe stadin e tyre të zhvillimit. Kështu në këtë takim u trajtuan tema të rëndësishme si: (i) Instruksione për vlerësimin mbikëqyrjes të fondeve të pensioneve; (ii) Draft-instruksione për përdorimin e fuqisë ndërhyrëse, sanksioneve dhe detyrimeve; (iii) Pagesat dhe komisionet, projekt raport për publikim; (iv) Informacion dhe diskutim për çështje të anuities; (v) Drejtimi i autoriteteve mbikëqyrëse; (vi) Strukturat mbikëqyrëse; (vi) IOPS “Toolkit” për mbikëqyrjen mbi bazë risku; Moduli 2 – Fuqitë rregullatore dhe kërkesat për RBS – OECD; Moduli 3 – Tools për RBS – Kili, Gjermania; Moduli 5 – Modeli i klasifikimit të riskut, Kenia, Afrika e Jugut, UK; Moduli 6 – Përgjigjet mbikëqyrëse, Australia, Hungaria; etj.

Me shumë interes qenë trajtimi i disa temave, Australia – Detyrimi efektiv dhe piramida e detyrimit (bindja, letra paralajmëruese, padia civile, padia kriminale, pezullimi i licencës, heqja e licencës), UK – Afrimi drejt detyrimit, Afrika e Jugut – Qeverisja e mire e fondeve të pensioneve.

Temat e paraqitura u trajtuan me shumë profesionalizëm dhe pati mjaft diskutime e pyetje rreth tyre. Në fund të takimit u miratua axhenda për muajt në vazhdim, ku më i rëndësishmi do të jetë takimi vjetor në Kenia, në tetor 2008.

¹ The International Organization of Pension Supervisors

² Organization for Economic Co-operation and Development

³ International Accounting Standards Board



III.2 Vizitë pranë Autoritetit të Tregjeve Financiare Austriake, me qëllim studimin e sistemit të raportimit statistikor të shoqërive të sigurimit me aktivitet në Austri.

Nga data 9-10 qershor 2008, pranë zyrave të FMA, u organizua në formën e një seminari dy ditor, vizita me qëllim studimin e sistemit të raportimit statistikor të shoqërive të sigurimit me aktivitet në Austri.

Seminari filloi me fjalën përshëndetëse të Z. Harald Unger, prezantimin e axhendës që do të ndiqej gjatë këtyre dy ditëve, si dhe prezantimin statistikor mbi tregun e sigurimeve në Republikën e Austrisë e operatorëve të ndryshëm që operojnë në këtë treg.

Më pas Zj. Alma Qamo, përfaqësuese e grupit të AMF, bëri një prezantim mbi Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, organizimin e institucionit dhe shifrave statistikore të tregut të sigurimeve në Shqipëri.

Në aspektin teknik të sistemit të raportimit të FMA, prezantimi u vazhdua sërish nga z. Harald Unger, ku u renditën pikat kryesore të sistemit të raportimit të FMA, të cilat përmblihen si më poshtë:

o Sistemi i raportimit VISO, ishte një përmbledhje komponentësh dhe aplikacionesh të zhvilluar që në vitin 2001.

o Sistemi ishte zhvilluar nga ana e Shoqatës së Siguruesve të Austrisë me burime të jashtme (outsource) dhe FMA kishte akses me të drejta administruese në këtë sistem.

o Sistemi mirëmbahet dhe ishte i lokalizuar në

Shoqatën e Siguruesve. Aksesit në sistem nga ana e shoqërive të sigurimit bëhej nëpërmjet internetit, me anën e portalit të vënë në dispozicion në faqen e FMA.

o Të gjitha Shoqëritë e Sigurimit kanë detyrim ligjor të sigurojnë të dhëna të tyre të brendshme drejt FMA dhe janë të detyruar ti radhitin me çfarëdo lloji ndryshimi raportimi të dhënash që kërkon FMA.

o FMA nëpërmjet panelit të administrimit përcakton të dhënat që duhen raportuar, tipin e të dhënave dhe intervalin e të dhënave. Këto përcaktime zbatohen në formatin XML dhe skedarët XML të krijuar importohen në sistemin e raportimit për të reflektuar ndryshimet e kërkuara nga FMA, si në ndërfaqe, ashtu dhe në logjikën e aplikimit.

o Shoqëritë e sigurimit kanë një afat kohor të caktuar për t'iu përshtatur ndryshimeve në raportim të imponuara nga FMA.

o Të dhënat e raportuara ruhen në serverat e Shoqatës Austriake të Shoqërive të Sigurimit, në të cilat vetëm FMA ka të drejtë për të transferuar dhe për të procesuar të dhënat, me qëllim kryerjen e analizave.

o Procesimi i të dhënave mbaron me një konfirmim elektronik për marrjen e të dhënave me e-mail drejt shoqërive të sigurimit.

o Platforma e VISO suporton eksportimin e të dhënave për standarde të njohura si EUROSTAT, OECD, etj.

Sistemi VISO midis të tjerëve është i përbërë nga këto komponentë kryesorë:

Master Database Tool, i cili konsiston në aplikacionin qendror të ruajtjes së informacionit. Në të ruhen të gjithë informacionet bazë mbi shoqëritë e sigurimit, duke përfshirë këtu:

o Informacione kryesore mbi kompaninë (emri, NIPT, adresa, email, etj), emrin dhe periudhën e funksionimit për postet kryesore në kompani (drejtor i përgjithshëm, drejtor degësh, drejtor departamenesh kryesorë, aktuarë të licencuar, etj.)

o Klasa e licencimit

o Shkëmbim shërbimesh në vende të huaja.

o Degë në vende të huaja.

o Informacion mbi aksionerët dhe aksionet.

o Informacion ligjor në lidhje me mbikëqyrjen

o Informacione të tjera të rëndësishme në lidhje me shoqërinë e sigurimit.

Data Analysis Tool, është shërbimi kryesor i përdorur për krijimin e raporteve të ndryshme të mbështetur në të dhënat e mbledhura nga raportimi i shoqërive. Ky shërbim, jep mundësinë e krijimit të raporteve në format Excel apo dhe në formate të tjera tekst të njohura nga programe procesimi, si Microsoft Word. Raportet klasifikohen në varësi të kriterit të zhvillimit të tyre si p.sh raporte për shoqëri, raporte në nivel tregu, raporte vjetore, raporte tremujore, etj.

Developer Tool, shërbimi i zhvillimit që bën të mundur zhvillimin, konfigurimin dhe ndryshimin e formateve të raportimit. Ky shërbim prodhon disa skedarë në format xml, të cilët më pas shërbejnë si parametra hyrje për sistemin e raportimit, me të cilin ndërfaqosen shoqëritë e sigurimit.

INSURE, ky sigurim, përbën aplikacionin kryesor me anën e të cilit realizohen analizat e shoqërive të sigurimit. Ky aplikacion është konceptuar në formën e një data warehouse, i cili pranon hyrje nga shumë burime të dhënash për të kryer raporte komplekse.

Një nga aspektet më interesante të programit Insure, ishte moduli i pyetjeve i plotësuar në formën e një testi online. Një përdorues me të drejta administrative mund të konceptojë disa

pyetje në lidhje me aktivitetin apo një parametër të caktuar në sigurim, duke i dhënë kësaj pyetje një peshë të caktuar specifike të përcaktuar gjithmonë nga mbikëqyrësi (në rastin tonë FMA). Më pas një specialisti tjetër p.sh një specialisti të inspektimit i paraqiten pyetjet që kanë të bëjnë me profilin e tij (p.sh atij nuk i paraqiten pyetjet që kanë lidhje me provigjionet teknike, të cilat i paraqiten një aktuari) dhe ai i përgjigjet kësaj pyetje në formatin e caktuar nga administratori (përgjigje po/jo, përgjigje me sqarim e shoqëruar me koment, intervale, etj.) Duke mbledhur përgjigjet e pyetjeve të ndryshme nga specialistë të ndryshëm, pikët korrespondente përcaktojnë një përgjigje lidhur me nivelin e shoqërisë specifike të sigurimit.

Nga pikëpamja e shërbimeve dhe zhvillimeve në fushën e teknologjisë së informacionit, kjo eksperiencë ishte e dobishme në këndvështrimet e mëposhtme:

o U përfitua një demonstrim konkret i një sistemi statistikor dhe analitik të integruar, i cili përfshinte të gjithë aspektet apo këndvështrimet e raportimeve të ndryshme, duke filluar që nga të dhënat e përgjithshme për kompanitë deri tek të dhëna specifike mbi biznesin, si dhe analizat e ndryshme të cilat bëheshin në këto të dhëna.

o U prezantua me workflow e procesit të raportimit, proces i cili përfshinte disa instanca si Autoriteti i Tregjeve Financiare (FMA), Shoqata e Siguruesve dhe shoqëritë e sigurimit. Natyrisht gjithë procesi realizohej nëpërmjet administrimit dhe kontrollit të FMA.

o U prezantua me skemat e raportimit të aplikuara në Solvency II. Ky fakt ishte shumë i dobishëm, sepse ishte një skemë, e cila në një të ardhme do të aplikohet dhe në tregun shqiptar të sigurimeve.

III.3 Pjesëmarrje në seminarin “Mbi disa aspekte të veçanta të politikave të tregut të brendshëm në Bashkimin Evropian”

Njësia e Ndërtimit të Institucioneve të Bashkimit Evropian (TAIEX) organizoi një seminar, më datë 30.06.2008, në ambientet e Hotel Tirana Internacional, “Mbi disa aspekte të veçanta të politikave të tregut të brendshëm në Bashkimin Evropian”.

Qëllimi i këtij takimi ishte të sensibilizonte dhe të ofronte informacion mbi tregun e brendshëm të Bashkimit Evropian, në lidhje me principet dhe procedurat kryesore, duke përfshirë edhe një përmbajtje të shkurtër të disa kapitujve të veçantë të legjislacionit evropian mbi tregun e brendshëm.

Në takim u bënë prezantime nga studiues dhe ekspertë të ndryshëm si, Z. Panos Gredis, përfaqësues i Ministrisë Greke të Ekonomisë dhe të Financave, Z. Jozef Sarai, Kryetar i Departamentit Ndërkombëtar të Autoritetit Hungarez të Konkurrencës, Zj. Edlira Baraj, Drejtor i Zyrës së Ndihmës Shtetërore në Shqipëri, Z. Charles-Henry Massa, kërkues në Institutin e Universitetit Evropian në Itali, Zj. Nathalie Berger, përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Tregut dhe Shërbimit të Brendshëm të Komisionit Evropian, Zj. Nikolina Gjordeni, Drejtor i Zyrës të së Drejtës të Autorit në Shqipëri dhe Z. Marius Gogescu, President i Autoritetit Kombëtar për Rregullimin dhe Monitorimin e Prokurimeve Publike në Rumani.

Në këtë takim, përfaqësuesit e administratave të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, diskutuan dhe shpjeguan aktivitetet dhe legjislacionin e BE-së në fushën e lëvizjes së

lirë, politikave të konkurrencës, prokurimeve publike dhe në fushën e pronësisë intelektuale.

Ndër temat e ndryshme që u diskutuan theksi u vendos kryesisht në strukturën organizative dhe principet e tregut të brendshëm evropian, në katër liritë e lëvizjes së lirë dhe në rregullat dhe principet kryesore të konkurrencës.

Gjithashtu, një theks i rëndësishëm u vu edhe në përafrimin e legjislacionit shqiptar në fushën e prokurimeve publike dhe pronësinë intelektuale me direktivat evropiane.

Prezantimet e përfaqësuesve të huaj u pasuan me prezantimet e homologëve të tyre shqiptarë, të cilët shpjeguan ecurinë dhe reformat shqiptare që do të ndërmerren në fushat e mësipërme në kuadër të MSA-së.

III.4 Pjesëmarrje në seminarin e organizuar në Stamboll, mbi aspektet e rregullimit të paketës kontrolluese të aksioneve

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO), EMC Working Group, Bordi i Tregut të Kapitaleve të Turqisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare Polake, organizuan në Stamboll, Turqi, gjatë periudhës 11 – 14 qershor 2008, seminarin, mbi aspektet e rregullimit të paketës kontrolluese të aksioneve.

Në seminar u trajtuan dhe diskutuan shumë çështje mbi rregullimin e paketës kontrolluese të aksioneve, jo vetëm të natyrës së mbikëqyrjes.



Fillimisht u prezantuan rezultatet e pyetësorit të organizuar nga IOSCO për vendet anëtare të Working Group 4, duke bërë të njohura rezultatet në lidhje me detyrimet për transparencë të investitorit, kërkesat për transparencë për zotërimin e një blloku aksionesh, si dhe sanksionet në rast të mospërbushjes së këtyre kërkesave. Rezultatet e pyetësorit u prezantuan edhe në lidhje me ofertën në blerje (tender offers), për pragun e kërkuar ose bllokun e aksioneve të cilat kërkohen të blihen, përjashtimet nga detyrimi për të shpallur një ofertë në blerje dhe tërheqjen e një shpallje të tillë.

Në seminar u prezantuan gjithashtu, parashikimet e direktivave të BE-së dhe parimeve të IOSCO-s në lidhje me paketën kontrolluese, përafrimin e tyre me zhvillimet e tregut, si dhe mënyrat e implementimit të tyre në rregullime ligjore nga rregullatorët. Këtu u theksua se nuk ka një mënyrë të vetme të përafrimit tek çështjet e rregullatorit. Legjislacionet dhe struktura e rregullatorit varion nga një juridiksion tek tjetri dhe reflekton kushtet vendore të tregut dhe zhvillimin historik.

Nga prezantimet e lektorëve të ndryshëm në seminar u ekspozua mënyra e ndryshme e

rregullimit. Në disa vende paketa kontrolluese rregullohet me ligj nëpërmjet kodeve të hartuara për këtë qëllim, si p.sh. në Angli, Malajzi apo Maltë, etj. Ndërkohë që në vende të tjera, si Turqia, është bërë përpjekje që aspekte të transparencës apo njoftimeve, në rast të kalimit të një pragu të caktuar për blerjen e aksioneve, të rregullohen me ligjin e shoqërive tregtare (draft përtej së shpejti miratimi) duke shtrirë detyrimin edhe tek shoqëritë jopublike ose të palistuara, ndërkohë aspekte të tjera të paketës kontrolluese rregullohen në ligjin organik të letrave me vlerë. Në modelin me kod të rregullimit, kërkesat për paketën kontrolluese shtrihen edhe në shoqëritë e palistuara në Bursë.

Mbikëqyrja e procesit në disa vende kryhej nga Autoriteti Rregullator i Tregut të Kapitaleve, ndërkohë që në disa prej tyre (të pakta) janë krijuar struktura të veçanta, (paneli në Angli) i cili merret vetëm me edukimin dhe konsultimin e procedurave që duhet të ndjekin shoqëritë gjatë këtij procesi, si dhe me ankesat në rast të mos zbatimit të procedurave të kodit të paketës kontrolluese.

Seminari u cilësua shumë i vlefshëm e në fund të tij u shpërndanë certifikata të pjesëmarrjes për të gjithë të pranishmit.



III.5 Takimi i shtatë në Lisbonë “Mbi sigurimet shoqërore dhe sistemet e fondeve të pensioneve suplementare, etika dhe qeverisja e tyre”

Qendra e kërkimit të ISEG (CIEF) së bashku me Institutin Qendror të Universitetit Teknik të Lisbonës, ISEG, zhvilluan në ambientet e Universitetit Teknik të Lisbonës, Portugali, në datën 6 qershor 2008, takimin e shtatë, mbi sigurimet shoqërore dhe sistemet e fondeve të pensioneve suplementare, etika dhe qeverisja e tyre.

Qëllimi i takimit ishte të ofronte një forum për kërkim dhe diskutim me autoritete kompetente, në lidhje me çështjet:

- o Menaxhimi i riskut të fondeve të pensioneve.
- o Përfitimet dhe disavantazhet e kalimit, nga përfitime të përcaktuara në kontribute të përcaktuara.
- o Prezantimi i sistemeve alternative të vendeve të tjera, etj.

Në këtë takim u diskutua për mënyrën e menaxhimit dhe qeverisjes së fondeve private të pensioneve. U bënë prezantime nga studiues dhe ekspert të ndryshëm si, Zj. Fiona Stewart, ekonomiste për pensionet private pranë OECD-së, Z. Jorge Miguel Bravo, përfaqësues i Universitetit të Evorës, Z. Gustavo Ferro, përfaqësues i Institutit të Ekonomisë, Argjentinë dhe Z. Timotheos Angelidis, nga Universiteti Peloponez, Greqi.

Ndër temat e ndryshme që u diskutuan, theksi u vendos kryesisht në strukturën organizative të fondeve të pensioneve dhe në qëndrueshmërinë e kësaj të fundit. Pjesa më e madhe e fondeve nuk funksionojnë, si pasojë e mosfunksionimit të strukturave drejtuese, gjë

që sjell edhe rrezikimin e interesave të kontribuuesve. Një zgjidhje e mundshme në këtë drejtim, do të ishte dhënia e më shumë mundësive kontribuuesve për t'u bërë pjesë e njësisve organizative.

Me shumë interes në takim qenë prezantimet e sistemit Grek dhe atij Argjentinës. Këto prezantime patën rëndësi, pasi ofruan mundësinë e njohjes me skema pensionesh të tjera, gjë që është pozitive për një vend si Shqipëria, e cila po përpiqet të përfshijë kolonën e dytë dhe të riorganizojë kolonën e tretë.

III.6 Vizitë studimore, me qëllim studimin e sistemit të raportimit statistikor Vizor In-Reg të shoqërive të sigurimit me aktivitet në Slloveni

Nga data 19-20 qershor 2008, në Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Slloveni (ISA), u zhvillua seminari, me qëllim studimin e sistemit të raportimit statistikor Vizor In-Reg të shoqërive të sigurimit me aktivitet në Slloveni. Ky seminar ishte shoqëruar me vizitë në zyrat e Shoqërisë së Risigurimeve SAVA, prezantim mbi aktivitetin e kësaj shoqërie dhe vizitë në zyrat e Shoqatës së Risiguresve e prezantim mbi Bazën e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorrik të Sllovenisë (sistem analog me Regjistrin Online të Sigurimit të Detyrueshëm Motorrik në AMF).

Seminari pranë ISA filloi me një prezantim të shkurtër nga ana e Kryetarit të Agjencisë z. Mihael Perman, mbi historinë e krijimit dhe

zhvillimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Slloveni deri në ditët e sotme. U vunë re që etapat e transformimit në Slloveni kishin qenë të ngjashme me ato në Shqipëri, duke qenë se fillimisht Agjencia ishte krijuar si një sektor i veçantë nën juridiksionin e Ministrisë së Financave Sllovene dhe më pas kishte marrë statusin e një institucioni të pavarur në strukturën e Shtetit Slloven.

Interesant ishte fakti që në Slloveni, tregjet financiare jobankare nuk mbikëqyren nga një institucion i vetëm.

ISA konsiston në një institucion prej 30 vetash, i cili përbëhet prej këtyre katër sektorëve kryesorë:

- o Drejtoria e Aktuaristikës dhe Statistikës
- o Drejtoria e Inspektimit Onsite
- o Drejtoria Operacionale, e cila përfshinte shërbimet e brendshme si p.sh (Financa, Burimet Njerëzore, TI, etj)
- o Drejtoria e Analizës Financiare

Tregu i sigurimeve në Slloveni kishte një ndarje të ngjashme me tregun e sigurimeve në Shqipëri, duke qenë se pjesa më e madhe e primeve përbëhej nga sigurimet e jo-jetës veçanërisht MTPL. Në tregun slloven aktualisht operojnë 14 kompani sigurimi si dhe dy kompani risigurimi.

Raportimi i shoqërive të sigurimit realizohej në bazë tremujore, por jo online, nëpërmjet sistemit In-Reg. Synimi i ISA, ishte që brenda një viti me upgrade-n e sistemit të raportimit In-Reg në një version të ri, ky raportim të realizohej online. Faza fillestare e projektit të sistemit ishte financuar nga dega e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në Slloveni, ndërkohë që të gjithë shpenzimet e fazave të mëvonshme që kishin të bënin me mirëmbajtjen apo zhvillime të tjera, ishin financuar nga shoqëritë e sigurimit. ISA kishte një eksperiencë katër vjeçare me sistemin In-

Reg dhe gjatë kësaj periudhe kishte kaluar në disa problematika kryesore me mbështetje të konsiderueshme teknike e financiare, me Visor, ku më kryesoret ishin:

a. Problemet me bashkësinë e karaktereve speciale jo-latine, pjesë e alfabetit slloven (probleme të cilat mund të hasen, ndonëse në një shkallë shumë më të vogël dhe në alfabetin shqiptar si pasojë e shkronjave 'ç', 'ë', 'ç' dhe 'ë').

b. Problemet me kalimin e Sllovenisë nga monedha vendase në Euro, që sillte një rimodifikim dhe rikonceptim nga fillimi të raporteve dhe të inputeve të raportimit. Ky problem nuk ishte asimiluar ende nga ana e ISA duke qenë se një pjesë e raporteve ishin në monedhën vendase dhe një pjesë në Euro.

c. Probleme të lindura nga ndryshimi i formateve të raportimit, ndryshim ky që nuk mund të realizohej drejtpërsëdrejti nga ISA pa asistencën e Visor (ky problem në sistemin e ri do të eliminohej).

Aktualisht raportimi nga ana e shoqërive të sigurimit tek ISA nuk bëhej nëpërmjet sistemit In-Reg, por në rrugën konvencionale nëpërmjet skedarëve të Excel. Këto të dhëna më pas hidheshin në mënyrë manuale nga stafi i agjencisë në sistem, në të cilin bëhej më pas dhe kontrolli i kryqëzuar i të dhënave. Kjo procedurë ishte intensive dhe rrugëzgjdhje e vetme ishte raportimi direkt në sistem nga ana e shoqërive të sigurimit. Për këtë ishin menduar dy mënyra:

o Raportimi drejtpërsëdrejti nëpërmjet ndërfaqes së raportimit të vënë në dispozicion ndaj shoqërive të sigurimit.

o Përcaktimi i strukturës dhe rregullave të informacionit që do të raportohet nëpërmjet një file template në standard XML, i cili më pas importohet në sistemin e raportimit.

Sistemi i instaluar dhe i përdorur nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve – ISA, kishte këto module kryesore:

- a. Moduli i përpilimit dhe i përshtatjes së standardeve të raportimit.
- b. Moduli i ndërfaqësjes së përdoruesit, i ndryshueshëm dhe i konfigurueshëm në funksion të formateve të konceptuara dhe të përcaktuara nga administratori.
- c. Moduli i gjenerimit të raporteve në bazë të të dhënave të raportuara nga shoqëritë e sigurimit.
- d. Moduli i kontrollit të kryqëzuar të të dhënave të raportuara për të evidentuar gabime të rastësishme ose të qëllimshme, në të dhënat e raportuara nga ana e shoqërive.
- e. Moduli i menaxhimit të përdoruesve me të drejta të ndryshme shkrimi apo leximi, në raporte specifike të sistemit (p.sh një përdorues me profil aktuar kishte të drejtë të aksesonte vetëm raportet që kanë të bëjnë me aktuaristikën, etj)
- f. Baza e të dhënave mbështetëse, në të cilën ruhen të gjithë informacionet e raportuara nga ana e shoqërive të sigurimit.

Llogaritë e përdoruesve të hapura për secilën shoqëri sigurimi merrnin parasysh dhe klasën e sigurimit apo risigurimit për shoqërinë në fjalë. Një gjë e tillë realizohej në mënyrë që shoqërisë në fjalë t'i shfaqen vetëm format që i interesojnë (p.sh. një shoqërie sigurimi jo-jete nuk ka pse t'i shfaqen formatet e raportimit që kanë të bëjnë me shoqëritë e jetës).

Formatet e raportimit ishin përcaktuar nga ana e Agjencisë dhe më pas ishin vendosur në dispozicion të shoqërive të sigurimit, pavarësisht faktit nëse këto formate ishin të njëjta me formatet aktuale të përdorura nga

shoqëritë. Ky proces mund të jetë më i menaxhueshëm në tregun shqiptar, duke qenë se shoqëritë e sigurimit që operojnë nuk kanë një standard të mirëqenë raportimi.

Kodi burim ishte pronë e ISA. Një gjë e tillë është pozitive për faktin, që i lejon ISA një shkallë pavarësie dhe në rastin e shkëputjes apo përfundimit të kontratës së mirëmbajtjes me anën e Visor.

Në fund të aktivitetit u krye edhe një vizitë në ambientet e Shoqatës së Sigurimeve të Sllovenisë. Vizita në ambientet e saj ishte e dobishme, sepse Shoqata e Siguruesve ishte enti administrues i Bazës së të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorrik. Ky sistem ishte i limituar, thjesht në regjistrimin e policave të shitura në kohë jo reale me një procedurë batch (procedurë asinkrone e përbërë nga një seri veprimesh e ekzekutuar në një moment të caktuar) në bazën qendrore të të dhënave. Rrjedhimisht, duke qenë se sistemi nuk ishte në kohë reale, fleta e policës që i jepej klientit nuk kishte asnjë shenjë dalluese të gjeneruar nga sistemi qendror. Sistemi ishte i pajisur dhe me një motorr kërkimi në formën e një aplikacioni web, i cili i vihej në dispozicion entiteve të ndryshme si p.sh ISA-s apo dhe publikut për kërkimin e policave me kriteret e ndryshme si p.sh targa, numri i serisë, emri i policmbajtësit. etj.

III.7 Pjesëmarrje në seminarin rajonal të CEIOPS, Solvency II

CEIOPS (Komiteti Evropian i Mbikëqyrjes për Sigurimet dhe Pensionet) dhe Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Rumanisë, zhvilluan në Bukuresht, gjatë periudhës 12-13 qershor 2008, seminarin rajonal me temë “Solvency II”.

Në ditën e parë diskutimet ishin ndarë në tre pjesë:

1. Efekti i Solvency II në tregun e Evropës Lindore.
2. Metoda e proporcionalitetit në projektin e Solvency.
3. QIS (Studimet e Efekteve Sasiore), për këtë argument diskutime më të thelluara dhe me praktike do të vazhdojnë në shtator të 2008, në seminarin e Budapestit.

Në ditën e dytë u trajtuan:

1. Rishikimi i procesit të mbikëqyrjes.
2. Modelet interneale.

Ekspertët e grupit sollën eksperiencën e tyre për argumentin e rëndësishëm, Solvency II. Gjithashtu, edhe përfaqësuesit e autoriteteve të mbikëqyrjes së vendeve të BE-së sollën eksperiencën e tyre, nga këndvështrimi i autoriteteve në aplikimin e rregullave dhe modeleve të ndryshme në zbatimin e Solvency II në këto vende.

Një argument i rëndësishëm që u trajtua që, efekti i Solvency II dhe vështirësia e aplikimit në tregun e Evropës Lindore, duke pasur parasysh që është një treg relativisht i vogël dhe i kufizuar. Për këtë argument sollën eksperiencën e tyre përfaqësues të autoriteteve dhe të kompanive të sigurimit të Rumanisë e Bullgarisë.

Në seminar diskutuan lektorë, komisionerë të CEIOPS, përfaqësues të autoriteteve të ndryshme të vendeve të BE, si dhe përfaqësues të autoriteteve të vendeve të Evropës Lindore.

IV. Udhëzime të OECD-IOPS mbi licencimin e instituteve të pensionit

Këto udhëzime, të përgatitura nga Komiteti i Sigurimeve dhe Pensioneve Private të OECD, Grupi i Punës për Pensionet Private dhe IOPS, janë miratuar nga Këshilli i OECD, në Mars 2008.

I. Përkufizime

Licencë – Autorizimi i instituteve të pensionit për të vepruar në treg dhe/ose për të patur të drejtën e përfitimit tatimor. Kërkesat për licencim mund të zbatohen ose si pjesë e procesit të licencimit, ose nëpërmjet legjislacionit, përputhshmëria me të cilin duhet t'i nënshtrohet një mbikëqyrje të vazhdueshme.

Licencimi – Procesi nga i cili një autoritet i jep lejen një instituti pensioni për të vepruar në treg dhe/ose për të përfituar nga një tatim specifik. Ai përfshin një seri veprimesh, duke përfshirë vlerësimin e përputhshmërisë me kërkesat të veçanta përpara dhënies së lejes për të vepruar në treg dhe/ose lejes për përfitim tatimor, ose mund të përfshijë vlerësimin e statusit të përputhshmërisë me këto kërkesa.

Instituti i pensionit – Institut i pavarur juridik me kapacitet juridik dhe që ka përgjegjësi themelore juridike për fondin e pensionit. Ai mund të marrë formën e një instituti të pavarur juridik që vepron si një kujdestar në rastin kur fondi i pensionit është themeluar si një trust, si një shoqëri e administrimit të fondit të pensionit, ose si vetë një fond pensioni kur fondi i pensionit ka kapacitet juridik (p.sh. fondacionet apo shoqëritë kolektive). Një shoqëri sigurimesh ose ndonjë institut tjetër financiar mund të konsiderohet si një institut pensioni, nëse ka përgjegjësi juridike të një fondi pensioni, ose përputhet me përshkrimin e

bërë në fjalinë e parë të këtij përkufizimi. Termi “fond pensioni” nuk i referohet pjesëmarrësve në planin e pensionit, as vetë planit në fjalë, as punëdhënësit (përveç rastit kur punëdhënësi është gjithashtu një shoqëri e administrimit të fondit të pensionit apo ka kontraktuar në mënyrë direkte një shoqëri administrimi për t'u marrë me shoqërinë e pensionit).

Fondi i pensionit – Një bashkim aktivesh, juridikisht të ndara, që janë blerë duke kontribuar në një plan pensioni, më qëllimin e vetëm të financimit të përfitimeve nga ky plan. Anëtarët e planit/fondit kanë një të drejtë ligjore, ose përfitimi, ose disa kërkesa të tjera kontraktuale kundrejt aktiveve të fondit të pensionit. Fondet e pensionit mund të marrin formën e një trusti, të një instituti të pavarur me kapacitet juridik (p.sh. fondacion apo shoqëri kolektive), ose të një fondi ligjorisht të shkëputur por pa kapacitet juridik i administruar nga një shoqëri e administrimit të fondit të pensionit ose ndonjë institut tjetër financiar duke vepruar në emër të anëtarëve të planit/fondit. Termi “fond pensioni” nuk i referohet kontratave individuale të pensionit.

Shoqëria e administrimit të fondit të pensionit – Një tip instituti financiar në formën e një shoqërie që ka si veprimtari të vetme administrimin e fondeve të pensioneve të shkëputura juridikisht. Në disa vende këto institute financiare administrojnë vetëm aktivet e fondit të pensionit, ndërsa në disa vende të tjera ato mund të kenë të drejtën edhe për të pagur përfitimet.

Plan pensioni – Një kontratë ligjore e detyrueshme, e cila ka si qëllim të qartë atë të përfitimit të pensionit (në mënyrë që të përmbushen kushtet në lidhje me taksat ose dispozitat e kontratës, përveç rastit kur përfituesi është më i vjetër se mosha ligjore e daljes në pension, përfitimet nuk mund të paguhen ose do të paguhen vetëm një pjesë, pasi të jetë zbritur nga shuma në fjalë një gjobë

e konsiderueshme). Kjo kontratë mund të jetë si pjesë e një kontrate më të gjërë punësimi, gjë që mund të përcaktohet në rregullat ose dokumentet e planit të pensionit, ose mund të kërkohet me ligj. Përveç qëllimit të qartë për pension, plani mund të ofrojë përfitime të tjera shtesë si ato të invaliditetit për sëmundje dhe ato për familjarët.

Trust pensioni – Një skemë ligjore ku disa individë të caktuar (kujdestarët) të cilët ruajnë dhe mbajnë pronësi në emër të personave të tjerë (përfituesit). Më konkretisht, në fushën e pensioneve, kujdestarët që mund të jenë një bord individësh ose një shoqëri, veprojnë për interesin e vetëm të anëtarëve të institutit të pensionit dhe përfituesve të tjerë.

Regjistrimi – Përfshirja e të dhënave për sa i përket institutit apo planit të pensionit në një regjistër të mbajtur nga autoriteti rregullues dhe/ose mbikëqyrës. Në disa vende regjistrimi është përbërësi i vetëm ose i më rëndësishmi i procesit të autorizimit, përveç disa vlerësimeve që bëhen për kualifikimin e përfitimeve tatimore.

II. Parathënie

Qëllimi

1. Udhëzimet promovojnë procedura dhe kërkesa për licencim efikas dhe të paanshëm, duke forcuar kështu konfidencën në sistemin e pensioneve e të mbikëqyrjes dhe gjithashtu promovojnë zhvillimin e tregut të pensioneve, ndërsa shmangin pengesa të panevojshme për hyrjen në treg.

2. Udhëzimet gjithashtu parashikojnë një proces licencimi, që është në përputhje me parimet e përcaktuara nga autoritetet rregulluese financiare dhe mbikëqyrëse për të siguruar një koherencë rregullative.

3. Udhëzimet promovojnë synimin e një sistemi licencues dhe mbikëqyrës për të vendosur dhe për të mbajtur një sistem të fortë të administrimit të fondit të pensionit, duke ju kërkuar aplikuesve të instituteve të pensionit të tregojnë që kanë vendosur procedura dhe politika, të cilat janë konsistente me një sistem që kërkon të garantojë dhënien e përfitimeve të gjithë anëtarëve të planit të pensionit, ashtu siç janë përcaktuar në kushtet e planit dhe në përputhje me bazën ligjore për pensionet.

4. Udhëzimet mbështesin dhe plotësojnë në të njëjtën kohë mbikëqyrjen e vazhdueshme të planeve dhe instituteve të pensionit. Udhëzimet, gjithashtu, parashikojnë që kriteret për dhënien e licencës të jenë në përputhje dhe në mbështetje me ato kritere që zbatohen gjatë mbikëqyrjes së vazhdueshme. Në këtë mënyrë, procesi i licencimit shërben gjithashtu edhe si një mjet rregullues, i cili siguron që institutet e pensionit t'i plotësojnë në mënyrë të vazhdueshme kriteret më minimale edhe pas licencimit.

5. Udhëzimet plotësohen edhe nga udhëzime të tjera rregullative dhe mbikëqyrëse për pensionet të përgatitura nga OECD dhe IOPS, të cilat plotësojnë edhe më shumë kërkesat e përcaktuara në këto udhëzime.

Synimi i aplikimit

6. Këto udhëzime synojnë të zbatohen nga institutet e pensionit të administrura në mënyrë private nga punëdhënësi, që do të thotë një tip instituti, anëtarësimi në të cilat varet nga një marrëdhënie pune, pavarësisht nëse ato janë vullnetare apo të detyrueshme nga ana e punëdhënësve apo punonjësve dhe pavarësisht nëse kontributet përdoren si mjet parësor apo shtesë për financimin e të ardhurave të daljes në pension⁴.

7. Këto udhëzime nuk ju adresohen në mënyrë specifike institutive të tjera të pensionit por

megjithatë ato mund të zbatohen edhe nga institute private pensioni. Njëkohësisht, ato mund të jenë të vlefshme edhe për institutet e pensionit në sektorin publik.

8. Këto udhëzime përcaktojnë të gjithë procesin e licencimit për institutet e pensionit. Aplikimi konkret i këtyre udhëzimeve varet nga struktura e mekanizmave të sigurisë së çdo vendi, nga mënyra se si funksionon sistemi i pensioneve e politikat e punës në këtë vend dhe gjithashtu varet edhe nga natyra e mbikëqyrjes së vazhdueshme.

9. Në disa vende, ku sistemi i licencimit të plotë nuk aplikohet që në fillimet e veprimtarisë së instituteve të pensionit, ashtu siç përshkruhet në këto udhëzime, licencimi mund të limitohet vetëm në autorizimin për qëllime të përfitimit tatimor. Përveç kësaj të fundit, krijimi i një instituti pensioni mund të kërkojë vetëm paraqitjen e disa dokumentave të caktuara pranë autoritetit përkatës dhe regjistrimin e institutit dhe/ose planit të pensionit. Në këtë rast, regjistrimi i institutit dhe/ose të planit të pensionit nuk ka nevojë për kryerjen e një procesi miratimi nga mbikëqyrësi në bazë të këtyre udhëzimeve. Kjo alternativë, në krahasim me procesin e plotë të licencimit, mund të konsiderohet si e përshtatshme duke marrë parasysh sistemin e përgjigjthshëm legjislativ të vendit, mbikëqyrjen ekzistuese të instituteve financiare që merren me administrimin e fondeve/planeve të pensionit dhe gjithashtu varet edhe nga synimi që mund të ketë vendi për të lehtësuar krijimin e planeve të pensionit. Në vendet që i aplikojnë këto parime, është vendimtare që të ekzistojë një sistem legjislativ që është vazhdimisht i efektshëm (duke përfshirë edhe kompensimet në rast të veprimeve të padrejta të kryera nga institutet e pensionit) në mënyrë që të promovojnë një nivel të njëjtë mbrojtjeje me atë nivel që mund të arrihej me implementimin e procesit të plotë të autorizimit të përcaktuar në këto udhëzime.

10. Në mënyrë të njëjtë, kërkesat për një qeverisje të mirë, që janë kushte kryesore të licencimit, duhet të krijohen edhe për mënyrat alternative të licencimit me anën e legjislacionit dhe udhëzimeve duke vendosur detyrime mbi ato që drejtojnë institutet e pensionit. Në veçanti, ligji duhet të kërkojë që institutet e pensionit të kenë sisteme kontrolli të njëjtë dhe dokumentacion të saktë ashtu siç mund të kërkohej në një proces të plotë licencimi, që regjistrimi të mos jetë i mundshëm vetëm nga marrja e këtij informacioni nga instituti i pensionit. Legjislacioni duhet gjithashtu të lejojë anëtarët, të cilët janë prekur në mënyrë të pavaforshme nga veprime të ndryshme, të investigojnë dhe të ankohen për këto veprime dhe të lejojë që autoriteti mbikëqyrës të investigojë mbi shkeljet e kushteve që zbatohen në procesin e licencimit. Një nga bazat kryesore të kësaj është që sistemi legjislativ të jetë aq i zhvilluar, sa që zbatimi i kërkesave ligjore të kryhet në mënyrë sa më efçente dhe në përputhshmëri me ligjin.

11. Gjatë implementimit të këtyre udhëzimeve duhet të konsiderohet edhe rasti kur një institut pensioni nga një vend ku është licencuar në mënyrë të rregullt, vendoset në një vend tjetër dhe përfiton nga njohja që i është bërë duke u bazuar në licencën e marrë në vendin e tij⁵.

⁴ Në vendet e BE-së, këto Udhëzime mund të mos zbatohen nga institutet apo planet e pensionit të administrura në mënyrë private nga punëdhënës, i nëse janë jashtë qëllimit të Direktivës 2003/41/EC të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të 3 qershorit 2003 "Për aktivitetin dhe mbikëqyrjen e insituteve për pensionet profesionale" (Neni 2 I Direktivës).

⁵ Për shembull marrëveshjet dypalëshe të njohjes që përdoren në BE.

12. Në rastin kur instituteve financiare u jepet e drejta për të kryer funksionet e drejtimit dhe administrimit, procesi i licencimit duhet të limitohet deri në verifikimin e atyre çështjeve që nuk janë mbuluar nga mbikëqyrësit e tjerë të institutit financiar. Shembuj të këtyre çështjeve mund të jenë ato në lidhje me kapitalin, qeverisjen e dokumentet e qeverisjes dhe në lidhje me planin e biznesit të përmendura në udhëzimet 6.1, 7.2, 8.1 dhe paragrafin 7 të shënimeve.

13. Në rastin kur aplikuesi për licencë nuk ka filluar akoma të veprojë në treg, disa kërkesa specifike mund të mos jenë të aplikueshme në çastin e aplikimit për licencë. Shembuj të kësaj natyre mund të jenë menaxhim i riskut, mekanizmat e raportimit të brendshëm dhe të auditimit, dhe raportet e politikave investuese të përmendura në udhëzimet 3.1, 5.1 dhe 8.1 (vi). Në këto raste, përgatitjet për krijimin e procedurave apo politikave përkatëse duhet të evidentohen dhe duhet të lejojnë rishqyrtimin nga ana e autoritetit licencues.

Vijon në numrin tjetër...

Për këtë numër punuan:

A. Qamo, E. Shehi, R. Guri, K. Haxhi,
E. Basha, R. Eltari, E. Sheri,
L. Lloji, A. Mancaku, E. Kokona

